



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Ragip Begaj , Kryetar i Komunës së Malishevës Rrahim Morina , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić , Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani , U. D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 06/09/2019 Nr.020-790/16
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lloji i aktit:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Malishevës ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës Nr. 02/494 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës NR.02/402 Datë: 04.07.2019

I miratuar më datë: 30.08.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.09.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Ragip Begaj, gradonačelnik opštine Mališevo Rrahim Morina, predsedavajući Skupštine opštine Mališevo	
Kopija:	Jedinici za administriranje sa dokumentima u MALS-u Jedinici za administriranje sa dokumentima u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani, v.d. rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a	Dana, 06.09.2019 Br.020-790/16
Odgovorni službenici:	1. Službenik za potvrđivanje pravne procene Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština Ardita Latifi, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Mališevo	
Vrsta akta:	☐ Odluka skupštine opštine	

Poštovani gradonačelniče,

Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primio je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka Skupštine opštine br. 02/494 za ukidanje odluke Skupštine opštine br.02/402 od dana, 04.07.2019
Usvojena dana, 30.08.2019
Predložena na razmetranje u MALS-u dana, 02.09.2019

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti za odredbama zakonodavstva na snazi o lokalnoj samoupravi.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministritë Lokale Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data: 02.09-2019		
Titulli:		
Numërdhënës: M. L. L. L. L.	Shënim:	Vite:
020-790/16		



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/496

Datë: 02.09.2019


Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 40, nenit 82 paragrafi 1,2 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008"), nenit 10 dhe 19, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871, datë:12.11.2008, kërkesës nr.020-790/11 datë:22.07.2019 të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal (MAPL), Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -IX- (nëntë) të mbajtur me datë: 30.08.2019 merr këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS NR.02/402 DATË:04.07.2019

1. Kuvendi i Komunës së Malishevës shfuqizon vendimin nr.02/402 datë:04.07.2019 i miratuar në mbledhjen e mbajtur me datë:27.06.2019, që autorizon Kryetarin e Komunës të lidhë marrëveshje me Sindikatën Komunale të Arsimit parauniversitar në Komunën e Malishevës për ndarjen e zyreve për ushtrimin e punëve dhe aktiviteve të tyre.
2. Vendimi nr.02/402 datë: 04.07.2019 i miratuar me datë: 27.06.2019, shfuqizohet konform kërkesës nr.020-790/11 datë:22.07.2019 të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Malishevës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
MAPL-së
Drejtorive të KK-së
Arkivit të Komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministritet Lokale Samëprirë e Administracisë Ministry of Local Government Administration			
Data:			
Lloji:			
Shënim	Shënim	Shënim	Shënim



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/402

Datë: 04.07.2019

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 14 paragrafi 1, nenit 17, nenit 40, nenit 58 shkronja d, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 10, nenit 19, nenit 30 paragrafi 5 pika d, nenit 46 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, kërkesën nr.02/303 datë:22.05.2019, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -VII- (shtatë) të mbajtur me datë: 27.06.2019 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet vendimi nga Kuvendi i Komunës së Malishevës që autorizon Kryetarin e Komunës të lidhë marrëveshje me Sindikatën Komunale të Arsimit parauniversitar në Komunën e Malishevës për ndarjen e zyreve për ushtrimin e punëve dhe aktiviteteve të tyre.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi marrëveshja e cila do të lidhet nga Kryetari i Komunës, me Sindikatën Komunale të Arsimit parauniversitar në Komunën e Malishevës përcakton ndarjen e zyreve në objektin e Muzeut "Jahir Mazreku" në Malishevë.
3. Me marrëveshjen e cila do të lidhet përcaktohet koha e shfrytëzimi dhe bartja e shpenzimeve të krijuara nga shfrytëzimi i hapësirës gjatë ushtrimit të detyrave.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
MAPL-së
Drejtorive të KK-së
Arkivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministristvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ragip Begaj , Kryetar i Komunës së Malishevës Rrahim Morina , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Adrijana Hodžić , Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraaj , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Xhevat Tafa , U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Malishevës
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

Date: 18.07.2019
Nr. 020-790

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02-402 nga Kuvendi i Komunës që autorizon Kryetarin e Komunës të lidhë marrëveshje me Sindikatën Komunale të Arsimit parauniversitar në Komunën e Malishevës për ndarjen e zyrave për ushtrimin e punëve dhe aktiviteteve të tyre.
I miratuar më datë më datë: 27.06.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.07.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

los pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
	Vendim Nr. 02-402 nga Kuvendi i Komunës që autorizon Kryetarin e Malishevës të lidhë marrëveshje me Sindikatën Komurale të Arsimit parauniversitar në Komunën e Malishevës për ndarjen e zyrave për ushtrimin e punëve dhe aktiviteteve të tyre.	Vendimi Nr. 02-402, i miratuar nga kuvendi i komunës së Malishevës, nuk është në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, përkatësisht me Neni 8, i cili përcakton procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, dhe si i tillë nuk prodhon efekt juridik.

bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të nevojshëm në lidhje me këtë vlerësim.